

Osmani e informon
ambasadorin francez për
konsultimet me partitë
politike për konstituimin
e Kuvendit FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON BLOKADA INSTITUCIONALE

KONSTITUIMI I KUVENDIT DËSHTON PËR HERË TË 43-të, MANDATI I DEPUTETËVE NË RREZIK? FAQE 4-5



As për herë të 43-të deputetët e Kuvendit nuk kanë arritur ta konstituojnë legjislaturën e nëntë parlamentare. Partitë politike parlamentare nuk janë duke lëvizur nga qëndrimet e

tyre fillestare, duke akuzuar njëra-tjetrën për bllokadën në Kuvend. Në kontekst të kësaj bllokade dhe aktgjykimit të Kushtetueses, të hënën është përmendur edhe rrezikimi i

mandatit të deputetëve. Ndërsa shoqëria civile ka alarmuar se moskonstituimi i Kuvendit është duke rrezikuar ta bllokojë funksionimin e institucioneve të pavarura

**GJYKIMI I LIDERËVE
TË UÇK-së DREJT
FUNDIT: KËTO
JANË TË GJITHA
AFATET DHE DATAT
E RËNDËSISHME** F. 3



**MBI 2 500
RASTE TË ZJARREVE
NGA JANARI.
A KA KOSOVA
KAPACITET PËR
SHUARJEN E TYRE?** F. 7



AKTUALE



**GUCATI: KURTI, HASHIMIN
E KADRIUN I KA FOBI,
I SHEH EDHE NË ËNDËRR** F. 3

**POLICIA MBYLL 15 LOKALE NË
OPERACIONIN KUNDËR BIXHOZIT** F. 6

**BASHKËSHORTJA E ISH-POLICIT
TË ARRESTUAR NË SERBI: ASNJË
INSTITUCION NUK PO PËRGJIGJET,
SI MUND T'I TRAJTOJË KËSHU
SHTETI NJERËZIT E TIJ?** F. 3

EKONOMI



**AKB-ja: PRODUKTET SERBE KANË
PUSHTUAR TREGUN, QEVERIA PO
RREZIKON PRODHIMIN VENDOR
DHE VETËVENDOSJEN EKONOMIKE** F. 8

**GËRXHALIU: SISTEMI I
FISKALIZIMIT ËSHTË SHNDËRRUAR
NË EKSPERIMENT PËR INTERESA
TË GRUPEVE TË CAKTUARA** F. 8

SPORT



**DRITA PËRBALLET SONTE ME
DEIIFERDANGEN** F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Greqia urdhëron pushime nga puna për shkak të të nxehtit

Athinë, 7 korrik - Autoritetet greke kanë urdhëruar pushime të detyrueshme nga puna në zonat ku temperaturat pritet të kalojnë 40 gradë celsius.

Nga e diela disa pjesë të Greqisë janë përfshinë nga një valë e të nxehtit ekstrem, që pritet të zgjasë deri të enjten. Ministria e Punës ka ndaluar punën fizike jashtë dhe shpërndarjen e ushqimit nga ora 12:00 deri në orën 17:00.

Urdhri do të zbatohet kryesisht në rajonet qendrore të Greqisë dhe në disa ishuj. Punëdhënësve u është kërkuar, gjithashtu, të ofrojnë mundësi pune nga distanca.

Në Athinë nuk është marrë ndonjë masa emergjente, pasi vala aktuale e të nxehtit në kryeqytet nuk konsiderohet e pazakontë. Meteorologët presin temperaturat më të larta sot (e martë) dhe nesër (e

mërkurë), ndërsa parashikojnë një rënie të lehtë, në rreth 35 gradë, kah fundi i javës. Temperaturat më ekstreme pritet të shënohen në zonat e ulëta të rajoneve qendrore të Greqisë.

Në ishuj dhe përgjatë bregdetit, temperaturat pritet të jenë tre deri në pesë gradë më të ulëta sesa në pjesën kontinentale dhe në qendrat urbane.

Ndër rekomandimet më të

rëndësishme për qytetarët janë: shmangia e qëndrimit jashtë gjatë orëve të nxehta të mesditës, konsumimi i shumtë i ujit, shmangia e alkoolit, ngrënia e ushqimeve të lehta dhe evitimi i aktiviteteve sportive në ambient të hapur. Për të ndihmuar personat më të cenueshëm, si të pastrehët apo ata që nuk kanë ajër të kondicionuar, shumë qytete dhe komuna kanë vënë në



dispozicion ambiente me ajër të kondicionuar, ku njerëzit mund të strehohen.

Temperatura të larta janë duke mbizotëruar edhe në pjesë të tjera të Evropës, përfshirë edhe rajonin e Ballkanit.

Polonia vendos kontrole kufitare me Gjermaninë dhe Lituani

VARSHAVË, 7 KORRIK - Polonia ka rifilluar të hënën kontrollet në kufijtë me Gjermaninë dhe Lituani, duke ndjekur shembullin e masave të ngjashme të ndërmarra nga Gjermania më herët, me qëllim pengimin e azilkërkuesve.

Kryeministri polak Donald Tusk, qeveria e të cilit i ka mbijetuar një votëbesimi në parlament së voni, i ka paralajmëruar këto kufizime qysh nga java e kaluar. Presioni është rritur pasi grupet e ekstremit të djathtë në Poloni e kanë akuzuar Gjermaninë për transportimin e emigrantëve në territorin polak pas mbërritjes së tyre në Evropën perëndimore.

Kontrollet që kanë nisur natën e së dielës do të zgjasin fillimisht 30 ditë, por autoritetet mund t'i zgjasin edhe më tej nëse është e nevojshme, tha Ministria e Brendshme e Polonisë. "Migrimi i paligjshëm është thjesht një krim", ka thënë ministri i Brendshëm polak, Tomasz Siemoniak, gjatë një konference për medie.

Kufiri i Polonisë me Lituani, që shtrihet në 104 kilometra, do të ketë kontrole në 13 pika kalimi. Ndërsa kufiri me Gjermaninë, i gjatë 467 kilometra, do të ketë kontrole në 52 pika.

Autoritetet lituaneze thanë të hënën se janë të gatshme të përballen me bllokime të mundshme të trafikut në kufirin polak. "Nëse krijohet trafik i shtuar ne do të fillojmë ta menaxhojmë lëvizjen... për t'i minimizuar ndërprerjet dhe për t'i bërë kontrollet sa më të shpejta", ka thënë Antanas Montvydas, zëvendëseshëf i Shërbimit Shtetëror të Rojës



Kufitare të Lituanisë, për radion lituaneze.

Pas marrjes së detyrës në maj, kancelari gjerman Friedrich Merz, i cili e ka bërë politikën më të ashpër të migracionit shtyllë të fushatës së tij elektorale, ka urdhëruar rritjen e pranisë policore në kufi dhe tha se disa azilkërkues do të ndalohen të hyjnë në Gjermani.

Javën e kaluar Merz ka thënë se Polonia dhe Gjermania po bashkëpunojnë ngushtë për t'u siguruar që kontrollet kufitare të Gjermanisë të shkaktojnë sa më pak probleme dhe vonesa. "Mbrotja e kufijve kundër migracionit të parregullt është një interes që Gjermania e ka, Polonia e ka dhe fqinjët tanë evropianë e ndajnë me ne. Ne nuk duam

kontrole të përhershme kufitare", ka thënë të hënën Stefan Kornelius, zëdhënës i Merzit. Bashkimi Evropian ka një zonë udhëtimi pa viza, të quajtur Schengen, e cila u mundëson qytetarëve të shumicës së vendeve anëtare të udhëtojnë lirshëm përtej kufijve. Zvicra është gjithashtu pjesë e zonës Schengen, edhe pse nuk është

anëtare e BE-së. Sipas BE-së, shteteve anëtare u lejohet të rivendosin përkohësisht kontrole kufitare, në rast të ndonjë kërcënimi serioz, si siguria e brendshme.

Me rregulla, kontrollet kufitare duhet të zbatohen si mjet i fundit në situata të jashtëzakonshme dhe duhet të jenë të kufizuara në kohë.

12 ushtarë turq humbin jetën nga ekspozimi ndaj gazit metan në një shpellë në Irak

Ankara, 7 korrik - Ministria turke e Mbrojtjes ka njoftuar se dymbëdhjetë ushtarë kanë humbur jetën si pasojë e ekspozimit ndaj gazit metan gjatë një operacioni kërkimi në

një shpellë në territorin irakian. Sipas njoftimit zyrtar, të paktën 19 pjesëtarë të forcave turke janë ekspozuar ndaj gazit gjatë operacionit të kërkim-pastrimit të zhvilluar të dielën, dhe u

transportuan menjëherë në spital për trajtim mjekësor. Ministria ka konfirmuar se deri të hënën, 12 prej tyre kishin ndërruar jetë. Ushtarët po kërkonin trupin e një kolegu të

tyre, i cili kishte humbur jetën në një përplasje me armë në maj të vitit 2022. Megjithatë përpjekjet, autoritetet turke kanë bërë me dije se trupi i një ushtari ende nuk është gjetur.



GJYKIMI I LIDERËVE TË UÇK-së DREJT FUNDIT: KËTO JANË TË GJITHA AFATET DHE DATAT E RËNDËSISHME

PRISHTINË, 7 KORRIK - Procesi gjyqësor në rastin e liderëve të UÇK-së është drejt fundit. Pas përfundimit të rastit të prokurorisë, tashmë mbrojtja ka nisur përgatitjet e veta për ta paraqitur rastin e saj. Megjithatë, para kësaj, duhet të vendoset për mocionin e mbrojtjes lidhur me rrëzimin e disa prej akuzave.

Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë pasur kohë ta dorëzojnë mocionin për rrëzimin e akuzave deri më 12 qershor. Prokuroria e Specializuar e Hagës ka pasur kohë të përgjigjet në mocionin e mbrojtjes të hënën më 7 korrik. Gjyqtarët pritet ta marrin vendimin për këtë mocion në javën që fillon më 14 korrik.

Varësisht se cili do të jetë vendimi lidhur me mocionin, pritet të vazhdojë edhe procesi gjyqësor. Megjithatë, deri atëherë janë caktuar edhe disa data të tjera me rëndësi. Një konferencë për ecurinë e



çështjes do të mbahet të martën, më 22 korrik, në orën 14:00. Nëse mocioni rrëzohet, avokati i viktimave urdhërohet të përgatitet të ftojë dëshmitarët e tij më 16 korrik. Mbrojtja e krerëve të UÇK-së

duhet ta njoftojë Gjykatën Speciale deri më 16 korrik nëse synon të dorëzojë provat e veta. Mbrojtja duhet të dorëzojë provat dhe listat e dëshmitarëve deri më 21

korrik. Gjyqtarët kanë vendosur që konferencën statusore për rastin e mbrojtjes ta shtyjnë deri më 19 gusht. Rasti i mbrojtjes pritet të fillojë menjëherë pas 18 gushtit,

varësisht se si përcaktohen afatet. Konferenca përgatitore për rastin e mbrojtjes mbahet më 22 gusht.

Informacione për numrin e dëshmitarëve

20 deri në 25 dëshmitarë pritet t'i ketë mbrojtja e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare në Gjykatën Speciale të Hagës. Prej tyre, rreth 15 mund të ftohen për të dëshmuar "live" në gjykatë. Në një parashtrim të cilin e ka parë gazeta "Nacionale", thuhet se mbrojtja e Thaçit mund të thërrasë deri në 12 dëshmitarë që do të dëshmojnë në Gjykatë, por që edhe ky numër mund të reduktohet. Kurse mbrojtja e Jakup Krasniqit do të ketë 10 dëshmitarë, prej të cilëve maksimalisht pesë do të dëshmojë në Gjykatën Speciale. Aktualisht, mbrojtja e Veselit dhe Selimit nuk kanë planifikuar të ftojnë dëshmitarë.

BASHKËSHORTJA E ISH-POLICIT TË ARRESTUAR NË SERBI: ASNJË INSTITUCION NUK PO PËRGJIGJET, SI MUND T'I TRAJTOJË KËSHTU SHTETI NJERËZIT E TIJ?

PRISHTINË, 7 KORRIK - Arieta Spahiu, bashkëshortja e Arbnor Spahiut, ish-pjesëtar i Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, i cili po mbahet në paraburgim në Serbi, ka reaguar publikisht përmes një letre drejtuar institucioneve të shtetit. Në letrën e saj, Arieta Spahiu ka thënë se ndodhet në një gjendje të rëndë emocionale dhe shpirtërore, duke shprehur zhgënjimin e thellë ndaj heshtjes së institucioneve në raport me bashkëshortin e saj. "Kam dërguar letra, kërkesa, lutje në presidencë, në kryeministri, në ministri, në çdo institucion që ekziston. Por, nuk kam marrë asnjë përgjigje. Jo një telefonatë. Jo një interesim. Heshtje totale. Si mund të jetë kjo mënyra se si një shtet i trajton njerëzit e tij?", ka theksuar ajo.



Në këtë kontekst, Spahiu ka kërkuar kërkon reagim urgjent nga autoritetet shqiptare dhe ndërkombëtare, duke thënë se po lufton e vetme për të mbrojtur të drejtën e një njeriu të pafajshëm. "Ku të shkoj më? Ku t'i trokas në derë kur çdo derë mbyllet para meje? Sa e rëndë është kjo ndjesi kur nuk ndihesh më pjesë e një shteti që duhet të të mbrojë?", ka thënë ajo në reagimin e saj. Më tutje, ajo ka bërë apel që zëri i saj të mos injorohet, duke e mbyllur letrën me fjalët: "Ju lutem, mos heshtni më. Ju lutem, dëgjoni zërin tim. Ju lutem, reagoni sa nuk është vonë". Ish-polici Arbnor Spahiu ndodhet në paraburgim në Suboticë, Vojvodinë - Serbi, tashmë që një muaj nga arrestimi.

Gucati: Kurti, Hashimin e Kadriun i ka fobi, i sheh edhe në ëndërr

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Guçati, ka reaguar ashpër pas deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, ku ky i fundit në një intervistë televizive ka aluduar për rolin e krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, duke "dhënë

instruksione politike në dëm të shtetit të Kosovës". Guçati në emisionin "Kosova Live" në "T7" e ka cilësuar deklaratën si njërën nga më të poshtrat të dhëna ndonjëherë nga një kryeministër në detyrë. Ai ka theksuar se ajo nuk i ka hije një udhëheqësi shteti, sidomos në një moment kaq të ndjeshëm kur

pritet vendimi i Gjykatës Speciale për liderët e UÇK-së. "Në vend se t'u qëndrojnë pranë në këto momente të vështira, ai po i godet. Nuk kam asgjë personale me Kurtin, por ka frikë nga ata, i tutet konkurrencës. I ka fobi ata njerëz (Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli) dhe në ëndërr i sheh", ka thënë Guçati.





VAZHDON BLOKADA INSTITUCIONALE

KONSTITUIMI I KUVENDIT DËSHTON PËR HERË TË 43-të, MANDATI I DEPUTETËVE NË RREZIK?

As për herë të 43-të deputetët e Kuvendit nuk kanë arritur ta konstituojnë legjislaturën e nëntë parlamentare. Partitë politike parlamentare nuk janë duke lëvizur nga qëndrimet e tyre fillestare, duke akuzuar njëra-tjetrën për bllokadën në Kuvend. Në kontekst të kësaj bllokade dhe aktgjykimit të Kushtetueses, të hënën është përmendur edhe rrezikimi i mandatit të deputetëve. Ndërsa shoqëria civile ka alarmuar se moskonstituimi i Kuvendit është duke rrezikuar ta bllokojë funksionimin e institucioneve të pavarura

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 7 KORRIK - Të hënën është regjistruar përpjekja e 43-të e pasuksesshme e deputetëve për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës. Sikurse edhe në herët e kaluara, partitë opozitare - përfshirë PDK-në, LDK-në, AAK-në, Nismën dhe Listën Serbe - kanë refuzuar të propozojnë anëtarë për komisionin që do ta organizonte votimin e fshehtë për kryeparlamentarin, duke e konsideruar këtë proces antikushtetues. Në votim të hapur ata e kanë

kundërshtuar disa herë radhazi emërimin e Albulena Haxhiut nga Lëvizja Vetëvendosje në këtë pozitë. Vetëvendosje, e cila ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet parlamentare të shkurtit, është duke këmbëngulur se votimi i fshehtë është legjitim dhe vetëm në këtë mënyrë mund të ecet përpara. Në seancën e 7 korrikut që ka zgjatuar vetëm pak minuta, deputetët e PDK-së, LDK-së dhe AAK-së kanë dalë në foltore për t'i bërë thirrje Vetëvendosjes që t'i japë fund, siç e kanë quajtur ata, "cirkut politik", gjë që e kanë shtyrë

kryesuesin e seancës, Avni Dehari, të kërkojë ndërprerjen e fjalës së tyre.

Skenar i ngjashëm është zhvilluar edhe në seancën e parafundit më 5 korrik, porse ajo është mbajtur me disa orë vonesë, për shkak të, siç është thënë, një kërcënimi me bombë në Kuvend, që doli të ishte i rremë.

Më 26 qershor Gjykata Kushtetuese e Kosovës kërkoi nga deputetët që ta konstituojnë Kuvendin brenda 30 ditësh, por nuk shpjegoi se çfarë mund të ndodhë në rast të mosrespektimit të këtij vendimi.

Partitë politike vazhdojnë ta interpretojnë ndryshe-ndryshe atë.

Para seancës së 7 korrikut deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari Lila, ka thënë se një nga pasojat e mosrespektimit të vendimit të Kushtetueses në afat mund të jetë marrja e mandatit të deputetëve. "Nuk ka ndodhur ende që në një legjislaturë të merret mandati i të gjithë deputetëve të Kuvendit, por janë 120 deputetë të legjislaturës së 9 që mund t'u

merret mandati dhe të vazhdohet pastaj me deputetët që janë në listat e të gjitha partive politike", ka thënë Kusari Lila.

Ajo ka theksuar se Gjykata Kushtetuese ka treguar procedurën e konsitutumit të Kuvendit dhe, sipas saj, asnjëra formë e votimit nuk është e përjashtuar. "Tani ose mundet Gjykata ta sqarojë aktgjykimin e vet, të vijë me instruksione, gjegjësisht me shpjegime shtesë, apo partitë mund të dakordohen që ta konstituojnë Kuvendin vetëm sa për ta shpërndarë dhe për të shkuar në zgjedhje të parakohshme. Zgjidhje tjetër nuk shoh", ka thënë Kusari-Lila.

Edhe deputetja e Nismës Socialdemokrate, Xhevahire Izma, ka paralajmëruar se meqë Gjykata Kushtetuese ka vendosur afat 30 ditor për konstituimin e Kuvendit, në rast të mosrespektimit të këtij afati mund të rrezikohet mandati i deputetëve.

Ndërsa deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sala Jashari, ka akuzuar Vetëvendosjen se është duke u sjell sikur t'i kishte fituar mbi 50


për qind të votave. "Gjendem këtu sepse edhe sot në tentativën e 43-të LV-ja sillet sikur të kishte edhe më shumë se 50 për qind të votave. Ajo pretendon se është për ta votuar vetëm një të propozuar dhe në mënyrë të fshehtë. Ky nuk është kompromis. Kompromis është kur PDK-ja i ka dhënë mundësinë LV-së duke i thënë ne do t'i votojmë shumicën e emrave të LV-së për ta zgjidhur këtë situatë. Atëherë më tregoni, çfarë zgjidhje po kërkohet kur zgjidhja është përpara jush", ka thënë Jashari. Në anën tjetër, deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, e ka ndërlidhur opsionin e shpërndarjes së Kuvendit me "shantazh politik". Ai ka thënë se nuk po shihet ndonjë përpjekje nga Lëvizja Vetëvendosje që ta gjejë një marrëveshje politike për konstituim të Kuvendit. Më tutje, Haziri ka thënë se shpërndarja "vjen kur dështon Kuvendi ta zgjedhë qeverinë, jo kur dështon ta konstituojë vetveten, sepse ky është problem i partisë së parë". "Nuk është problem as i individit, as i

OSMANI E INFORMON AMBASADORIN FRANCEZ PËR KONSULTIMET ME PARTITË POLITIKE PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

PRISHTINË, 7 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Republikës së Francës në Kosovë, Olivier Guerot, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend dhe në rajon, si dhe për raportet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Francës.

Presidentja Osmani dhe ambasadori Guerot kanë diskutuar edhe lidhur me konsultimet që ka zhvilluar presidentja me subjektet politike në funksion të zbatimit të vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ka ritheksuar se respektimi i rendit kushtetues dhe demokratik është thelbësor për stabilitetin institucional dhe kredibilitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

“Në takim është diskutuar edhe për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Francës, përfshirë



thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme me interes

të përbashkët, si dhe për rëndësinë e mbështetjes së

Francës në rrugën njoftuar Presidencën e euroatlantike të Kosovës”, ka

Kosovës.

deputetit, por është çështje që i kërkohej partisë së parë që ta gjejë një formë për ta ndërtuar një marrëveshje politike”, ka thënë Haziri.

Javën e kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ftoi në takim përfaqësuesit e partive politike për t'i diskutuar opsionet për dalje nga kriza. Ajo e ka përmendur edhe mundësinë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për sqarime shtesë.

Moskonstituimi i Kuvendit rrezikon organet e pavarura

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), pas dështimit të 43-të për konstituimin e Kuvendit të Kosovës, ka deklaruar se moskonstituimi i Kuvendit po rrezikon ta bllokojë funksionimin e institucioneve të pavarura.

IKD-ja ka theksuar se

mosefikasiteti dhe dështimi për t'i emëruar anëtarët në organet kolegjiale dhe individuale, që janë kompetencë e Kuvendit, janë bartur edhe në legjislaturën e nëntë. “Pasoja e moskonstituimit tashmë janë të dukshme në mosfunksionimin e disa organeve dhe do të bëhen edhe më evidente në muajt në vijim për shkak të skadimit të mandateve të tjera”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Po ashtu, IKD-ja ka shtuar se përgjegjësia kryesore për këtë situatë i takon shumicës parlamentare të legjislaturës së kaluar, e cila, ndonëse kishte fuqinë për t'i realizuar këto emërimë, zgjodhi të mos veprojë, duke lënë pas dore dhe neglizhuar obligimet kushtetuese e ligjore. Sipas IKD-së, tashmë është identifikuar një numër institucioneve dhe agjencish të pavarura që po funksionojnë me vështirësi. IKD-ja ka

Kryeziu: Bllokada institucionale s'ka të bëjë as me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, duke iu referuar bllokadës në Kuvendin e Kosovës, ka thënë se kriza në thelb është veç për një çështje: “A do të jetë Albin Kurti kryeministër edhe për katër vitet e ardhshme?”. Ai ka thënë se bllokada institucionale që po zhvillohet aktualisht në Kosovë nuk ka të bëjë as me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, as me votimin e

fshehtë. “Këto janë vetëm shenja të jashtme të një krize politike shumë më të thellë, e cila po përshkallëzohet përditë. Gjithçka që po ndodh sot, është pjesë e strategjive për të zvarritur kohën dhe për të shmangur të përballen me krizën reale thelbësore. Në thelb, kriza që ndan sot spektrin politik në Kosovë është kjo: A do të jetë Albin Kurti kryeministër edhe për katër vitet e ardhshme? Për opozitën,

përgjigjja është e qartë: Jo e për Vetëvendosjen, po. Prandaj, kriza reale politike nuk është vetëm çështje procedurash, por përballje me një dilemë politike që kërkon një kompromis të pashmangshëm. Dhe pyetja është: A do të ndodhë ky kompromis tani, për të parandaluar thellimin e krizës, apo më vonë, kur çdo zgjidhje do të vijë si pasojë e dëmit të kryer?”, ka shkruar Kryeziu në “Facebook”.

përmendur institucionet që po punojnë me mungesë anëtarësh, si Gjykata Kushtetuese, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Institucioni i Avokatit të Popullit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media (KPM). Shoqëria civile ka protestuar disa herë para Kuvendit të

Kosovës, duke kërkuar që ky institucion të konstituohet pa vonesa të mëtejshme dhe ta fillojë përmbushjen e detyrimeve kushtetuese për emërimin e anëtarëve në institucionet e pavarura.

Togeri i FSK-së, Qendrim Imeraj, diplomon në ShBA

Prishtinë, 7 korrik - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka njoftuar se togeri i FSK-së, Qendrim Imeraj, ka diplomuar në ShBA.

“Toger Qendrim Imeraj ka përfunduar me sukses kursin bazë për oficerët e këmbësorisë në shkollën e këmbësorisë ‘Manoeuvre Center of Excellence’ në Fort

Benning, Georgia, ShBA”, ka njoftuar ai.

Maqedonci ka thënë se Imeraj është dekoruar student i dalluar me çmimin “Distinguished Honor Graduate”. “Toger Imeraj për shkak të rezultateve të larta të treguara gjatë trajnimit u dekoruar student i dalluar me çmimin “Distinguished Honor Graduate”. Ky çmim

ndahet për studentët që arrin rezultate të larta në të gjithë komponentët e kursit. Ky sukses përfaqëson jo vetëm përkushtimin personal të toger Imeraj, por edhe profesionalizmin dhe cilësinë e lartë të oficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës të cilët po arrin suksese në nivel ndërkombëtar”, ka thënë Maqedonci.



Policia mbyll 15 lokale në operacionin kundër bixhozit

PRISHTINË, 7 KORRIK - Drejtoria rajonale e policisë në Prishtinë, ka njoftuar se ka realizuar me sukses një operacion të gjerë policor në funksion të luftimit të veprimtarive të kundërligjshme që ndërlidhen me organizimin e skemave piramidale dhe lojërave të fatit apo bixhozit të jashtëligjshëm. Operacioni është zhvilluar nga 25 prilli i vitit 2025, me ç'rast janë vëzhguar dhe verifikuar 91 lokale të ndryshme, ku në 60 prej tyre ka kryer kontrolle të detajuara. Sipas policisë, 15 lokale janë mbyllur nga inspektorët e

Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për mungesë të dokumentacionit përkatës ose licencave. “Janë iniciuar 25 raste penale, janë evidentuar shënime zyrtare dhe raporte operative që lidhen me vepra penale të ndryshme, si: organizim i lojërave të fatit, posedim i paautorizuar i substancave narkotike, armëmbajtje pa leje, kultivim, përpunim dhe shitje e substancave narkotike. Janë arrestuar 34 persona, të dyshuar për përfshirje direkte në këto aktivitete të paligjshme. Nga ta, 8 janë ndaluar me masë

mbajtjeje prej 48 orësh, ndërsa 26 të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt. Përgjatë operacionit janë sekuestruar në cilësi të provave të rëndësishme edhe: 18 aparate për lojëra të fatit, 1 armë automatike ‘AK-47’, një armë e shkurtër, pajisje të laboratorit për kultivim, përpunim të substancave narkotike, para 5544.40 euro, 3 laptop, 2 printer për shtypje të tiketave, 3 aparate skenimi të tiketave, 16 telefona mobil të dyshuar se janë përdorur për pagesa online në bastore sportive”, ka njoftuar policia.



LISTA SERBE NIS PETICION KUNDËR NDËRTIMIT TË DY URAVE MBI IBËR

PRISHTINË, 7 KORRIK - Me nismën e Listës Serbe, partisë më të madhe serbe në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit, në Mitrovicë të Veriut nisi të hënën një peticion kundër ndërtimit të urave mbi lumin Ibër. Gurëthemelet e tyre janë vendosur më 1 korrik, me praninë e kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti. Qeveria e Kosovës ndau rreth tre milionë euro për ndërtimin e dy urave - njëra për këmbësorë dhe tjetra për trafik - dhe punimet rreth tyre pritet të përfundojnë në vjeshtë. Kurti ka thënë se qëllimi i këtij projekti është lidhja e Mitrovicës së Veriut me popullsi shumicë serbe, me Mitrovicën e Jugut, ku shumica e popullsisë është shqiptare. Ai, gjithashtu, ka thënë se qeveria është e përkushtuar për një “komunikim, qarkullim, bashkëpunim dhe shkëmbim më të madh midis Veriut dhe Jugut”.

Në anën tjetër, kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, i ka thënë Radio Televizionit të Serbisë përpara fillimit të nënshkrimit të peticionit, se qëllimi është “të tregohet një qëndrim i unifikuar i popullit serb, se ai nuk pranon vendime të njëanshme për projekte në dëm të komunitetit serb”. Ai ka thënë se peticioni do të jetë i disponueshëm për nënshkrim



gjatë dy ditëve të ardhshme, ndërsa më pas do t'i përcillet bashkësisë ndërkombëtare. Nga Bashkimi Evropian i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” më herët se çdo vendim për ndërtimin e infrastrukturës përgjatë lumit Ibër duhet të merret me kujdes dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse - përkatësisht me përfshirjen e plotë të të gjitha komuniteteve

të prekura. Urat, përndryshe, do të ndërtohen pranë urës kryesore mbi lumin Ibër, e cila është pjesë e Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes, e arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Në këtë urë qëndrojnë vazhdimisht pjesëtarë të misionit paqeruajtës të NATO-

s, KFOR, pasi ajo njihet për konflikte etnike në periudhën e pasluftës. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore për mbylljen e saj për qarkullimin e makinave. Aktualisht, ajo është e hapur vetëm për këmbësorë. Verën e kaluar, Qeveria e Kosovës paralajmëroi se ajo mund të hapet për trafik - gjë që i rriti tensionet dhe shkaktoi reagime

nga bashkësia ndërkombëtare. Kryeministri në detyrë, Kurti, ka thënë se qeveria e tij nuk do të heqë kurrë dorë nga hapja e urës kryesore. Pjesëtarë të komunitetit serb nga Mitrovica e Veriut i kanë thënë më herët “REL”-it se hapja e urës kryesore vetëm se do t'i rriste tensionet në terren, ndërsa shqiptarët nga Mitrovica e Jugut deklaruan se një veprim i tillë do të kontribuonte në bashkëjetesë dhe liri të lëvizjes. Në vitin 2014, Kosova dhe Serbia kanë rënë dakord për hapjen e urës kryesore për trafik, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. I ashtuquajtur i rivitalizim i urës ishte planifikuar me qëllim heqjen e të gjitha barrikadave të vendosura nga serbët lokalë dhe funksionalizimin e urës. Më pas, në vitin 2016 është miratuar një plan i ri zbatimi, që synonte kapërcimin e mosmarrëveshjeve mbi interpretimet e ndryshme të konstatimeve të mëparshme. Sipas planit të ri të zbatimit, hapja e plotë e urës duhej të bëhej në janar të vitit 2017. Punimet rreth rivitalizimit të urës përfunduan vetëm në qershor të vitit 2018 dhe ura, në të cilën u investuan 1.5 milion euro, nuk u hap kurrë për automjete, por vetëm për këmbësorë.

Kryeqyteti zgjat orarin e punës për disa shërbime komunale

PRISHTINË, 7 KORRIK - Komuna e Prishtinës ka njoftuar për zgjatjen e orarit të punës për disa shërbime komunale deri në orën 17:00, duke filluar nga data sot (e martë). “Të nderuar qytetarë, ju njoftojmë se për shkak të fluksit të shtuar të qytetarëve dhe pranisë së bashkatdhetarëve nga diaspora, kryeqyteti Prishtina

ka vendosur të zgjasë orarin e punës për disa shërbime komunale deri në ora 17:00, duke filluar nga data 08.07.2024”, ka njoftuar komuna e Prishtinës. Sipas njoftimit, orari i ri i zgjatur përfshin Qendrën për Shërbime me Qytetarë dhe Gjendjen Civile në objektin e komunës së vjetër dhe asaj të

re. Po ashtu, orari është zgjatur edhe në Bashkësinë Lokale në lagjen e Muhaxherëve. “Kjo masë është implementuar për të siguruar të gjitha dokumentet e nevojshme si dhe për t’ju shërbyer më mirë e për t’i përmbyshur të gjitha kërkesat e qytetarëve tanë”, ka njoftuar komuna e Prishtinës.



AKTAKUZË NDAJ DY PERSONAVE PËR VEPRËN PENALE “TRAFIKIM I NJERËZVE”

Ferizaj, 7 korrik - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për të Mitur, ka njoftuar opinionin publik se ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve me inicialet E. S, dhe V. H. për shkak të dyshimit të bazuar të veprave penale “Trafikimi i njerëzve” dhe “Frikësim gjatë procedurës penale” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës së prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se nga muaji gusht i vitit 2024 e deri me datën 15.03.2025 në magjistralen Ferizaj - Prishtinë pn, Ferizaj, të pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, në vazhdimësi, marrin pjesë në trafikimin e njerëzve, në atë mënyrë që, fillimisht e pandehura V. H. fton të dëmtuarën në banesën e saj për të banuar përkohësisht, e pastaj në koordinim të plotë edhe me të pandehurin E. S., përmes kanosjes dhe përdorimit të forcës, sipas kërkesave të klientëve të tyre, u ofrojnë vajza për shërbime seksuale. Në periudhën e njëjtë kohore dhe në lokacionin e njëjtë, të

pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, në vazhdimësi marrin pjesë në trafikimin e njerëzve, në atë mënyrë që, fillimisht e pandehura fton të dëmtuarën e moshës 17-vjeçare për të banuar përkohësisht në banesën e saj, e pastaj në koordinim të plotë edhe me të pandehurin E. S., përmes kanosjes dhe përdorimit të forcës, sipas kërkesave të klientëve të tyre, u ofrojnë vajza për shërbime seksuale, saktësisht të miturën, duke u siguruar të njëjtave klientë të ndryshëm me të cilët bëjnë marrëveshje që të kryejnë marrëdhënie seksuale në këmbim të parave në vlerë prej 50 euro deri 400 euro, e të cilat para të pandehurit i përvetësojnë për vete, duke i ndarë në mënyrë proporcionale. Kurse me datën 16.03.2025 në magjistralen Ferizaj - Prishtinë pn, Ferizaj, të pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, në vazhdimësi, marrin pjesë në



trafikimin e njerëzve, në atë mënyrë që, fillimisht e pandehura fton të dëmtuarën e moshës 17-vjeçare për të banuar përkohësisht në banesën e saj, e pastaj në koordinim të plotë edhe me të pandehurin, përmes kanosjes dhe përdorimit të forcës, sipas kërkesave të klientëve të tyre, u ofrojnë femra për shërbime seksuale, saktësisht të dëmtuarën e mitur, ku e njëjta ishte detyruar se bashku të dëmtuarat e tjera, të hyjnë brenda në vilë të kryejnë shërbime seksuale duke u siguruar të njëjtave, klientë të ndryshëm me të cilët bën marrëveshje që të kryejnë marrëdhënie seksuale në këmbim të parave, në vlerë prej

50 euro deri 400 euro, e të cilat para të pandehurit i përvetësojnë për vete, duke i ndarë në mënyrë proporcionale, dhe posa dalin nga vilat, aty të pandehurit i marrin me veturë, nga aty vazhdojnë për në drejtim të qytetit të Prishtinës ku ndalen përsëri në motel kinse për të pushuar, derisa e dëmtuar arrin t'i dërgojë një audio-mesazh të dashurit të saj, dhe falë intervenimit të policisë, arrijnë që të pandehurit t'i arrestojnë, ndërsa e dëmtuara kërkon ndihmë mjekësore për shkak të gjendjes tejet të rënduar psikologjike të saj.

Ndërsa gjatë muajit mars të vitit 2025, në kohë të pacaktuar, përmes rrjetit social “Snapchat” e pandehura me qëllim të frikësimit dhe kanosjes serioze, si dhe duke premtuar dhuratë personave, saktësisht familjarëve të viktimave të mitura të trafikimit, saktësisht motrës dhe nënës së viktimës, në atë mënyrë që e pandehura derisa ishte nën masën e arrestit shtëpiak për shkak të veprës penale “Trafikimi i njerëzve” e njëjta fillimisht kontakton motrën e viktimave të trafikimit përmes llogarisë së saj të rrjetit

social “Snapchat” me mesazh zanor duke tentuar të krijoj një raport shoqëror dhe duke tentuar që t'i bind për të i ndryshuar deklaratat e tyre duke i thënë se të njëjtës ia ka premtuar një veturë të tipit “Golf 7” për ta hequr denoncimin në polici, ku, me këto veprime iu ka shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri për jetën e tyre.

Sipas prokurorisë, të pandehurit e lartcekur me këto veprime kanë kryer veprat penale në bashkëkryerje dhe në vazhdim “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, si dhe ndaj V.H., është paraqitur aktakuzë edhe për veprën penale “Frikësimi gjatë procedurës penale” nga neni 387 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartcekur të shpallen fajtor për veprat penale për të cilat akuzohen dhe të dënohen sipas ligjit.

MBI 2 500 RASTE TË ZJARREVE NGA JANARI. A KA KOSOVA KAPACITET PËR SHUARJEN E TYRE?

PRISHTINË, 7 KORRIK - Temperaturat e larta në vend dhe thatësitat janë shkaktarët më të mëdhenj të zjarreve që po ndodhin kohën e fundit, por duke mos përfshirur edhe faktorin njeri që në mënyrë të qëllimshme ndez zjarre. Vetëm përgjatë periudhës janar-qershor në Kosovë kanë qenë mbi 2 500 raste të zjarreve.

Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, Genc Metaj, ka thënë se i kanë marrë të gjitha masat, duke ngritur nivelin e gatishmërisë në të gjithë territorin e Kosovës. “Aktualisht jemi në kohën kur temperaturat janë të larta dhe janë kushte të cilat paraqesin rrezik për shkak të thatësisë për



ndezje të lehtë të zjarreve, mirëpo ne si Agjenci e Menaxhimit Emergjent i kemi marrë të gjitha masat, e kemi ngritur nivelin e gatishmërisë në të gjithë territorin duke përfshirë njësitet e zjarrfikësve dhe

shpëtimit, qendrat operative 112. Jemi në koordinim edhe me institucione tjera dhe aktualisht gjendja është më e qetë krahasuar me javën e kaluar që ka pasur një numër të madh të zjarreve, mirëpo me sukses kemi

arritur t'i shuajmë”, ka thënë Metaj për “Ksp”.

Sipas tij, Kosova ka kapacitete të mjaftueshme për shuarjen e zjarreve. “Kosova ka kapacitet të mjaftueshëm sepse janë njësitë profesionale të zjarrfikësve dhe me shoqata vullnetare nëse është e nevojshme. Mirëpo, si shtet kemi kapacitetet nëse ngritët nevoja për të kërkuar edhe angazhimin e njëjësive tjera qofshin ato të policisë apo ushtrisë, por edhe të emergjencave tjera në nivelin lokal apo qendror”, ka thënë ai. Më tutje, Metaj ka kërkuar nga qytetarët të vetëdijesohen dhe të mos ndezin zjarre qofshin ato në hapësira rekreative. “Ne i kemi mjetet, edhe pse një pjesë e tyre

janë të vjetruara, mirëpo gjendja aktuale është e mirë. Krahas kësaj duhet të ekzistoj një vetëdijesim qytetarë dhe shfrytëzoj rastin të bëj thirrje te qytetarët që të jenë të kujdesshëm, ta ruajnë vendin. Vlen të ceket vendimi i ministrit të Punëve të Brendshme, i cili ka marrë një vendim shumë të rëndësishëm që ndalon zjarrëvënien në të gjitha format, jo vetëm zjarrëvënien e qëllimshme, por ndalon edhe ndezjen e zjarreve në hapësira të hapura qofshin ato rekreative, piknik ose edhe ndezjen e fishekzjarrëve”, ka thënë Metaj, duke shtuar se numri i zjarrfikësve nuk është i vogël, mirëpo ka nevojë për staf shtesë.

Prokuroria shkurton orarin e punës: Temperaturat në Pallatin e Drejtësisë arrijnë në 35 gradë celsius

Prishtinë, 7 korrik - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) kanë shprehur shqetësimin e thellë lidhur me kushtet e papërshtatshme të punës në Pallatin e Drejtësisë, konkretisht në ambientet e Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të shkaktuara nga mosfunksionimi i sistemit të ftohjes dhe temperaturat ekstreme që kanë përfshirë vendin tonë. Për shkak të

mosfunksionimit të sistemit të ftohjes dhe temperaturave jashtëzakonisht të larta, temperaturat brenda zyrave të këtyre prokurorive po arrijnë nivele mbi 35 gradë celsius, duke e bërë të pamundur zhvillimin normal të punës dhe duke rrezikuar seriozisht shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve. Në këtë drejtim, KPK-ja dhe ZKPSH-ja u kanë bërë thirrje kryeprokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe

Prokurorisë Themelore në Prishtinë që në kuadër të kompetencave të tyre, të marrin masa, përfshirë edhe reduktimin e orarit të punës, deri në përmirësimin e kushteve. KPK-ja dhe ZKPSH-ja, gjithashtu, informojnë opinionin se kërkesat e përsëritura për ndërhyrje dhe rregullim të sistemit të ftohjes nuk kanë marrë përgjigje për vite me radhë, ndonëse objekti i Pallatit të Drejtësisë

është nën menaxhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila ka përgjegjësinë për funksionalitetin e këtij objekti. Të gjendur përballë kësaj situate të papranueshme, KPK-ja dhe ZKPSH-ja i kanë bërë thirrje të qartë dhe të drejtpërdrejtë Ministrisë së Punëve të Brendshme që të ndërmarrë menjëherë masa konkrete dhe efektive për përmirësimin e kushteve



elementare të punës në këtë objekt, në mënyrë që të garantohen siguria dhe mirëqenia e punonjësve të sistemit prokuroria.

GËRXXHALIU: SISTEMI I FISKALIZIMIT ËSHTË SHNDËRRUAR NË EKSPERIMENT PËR INTERESA TË GRUPEVE TË CAKTUARA

PRISHTINË, 7 KORRIK - Vendimin e Ministrisë së Financave që bizneset të kalojnë nga përdorimi i arkave fiskale në një sistem të ri digjital brenda një afati 60-ditor, ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, e ka cilësuar si “eksperiment” i dështuar që, sipas tij, është zhvilluar pa dialog dhe në shërbim të interesave të ngushta. Në një intervistë për “Ekonomia Online”, Gërxhaliu ka deklaruar se ky vendim është dëshmi e mungesës së përgjegjesisë institucionale dhe e injorimit të sektorit privat në procese vendimmarrëse që prekin drejtpërdrejt ekonominë e vendit. “Në rend të parë, sistemi i fiskalizimit në Kosovë është shndërruar në një eksperiment i cili ka qenë shumë më tepër në interes të përfitimeve të grupeve të caktuara të interesit se sa në përfitime të shtetit. Ka qenë një proces maratonik deri sa është vu në binar fiskalizimi përmes arkave fiskale, një vendim i ri i ministrit të Financave rreth

kalimit nga arkat fiskale në sistemin e digjitalizimit e dëshmon më së miri që në Kosovë është varrosur partneriteti dhe dialogu publiko-privat. Bëhen vendime pa informim dhe pa një dialog të mirëfilltë me sektorin privat dhe fakti që ministri urdhëron diçka tjetër dhe nga ATK-ja shtohet presion për diçka tjetër e dëshmon më së miri mungesën e përgjegjesisë institucionale”, ka thënë ai. Sipas Gërxhaliut, procesi aktual ka krijuar konfuzion për shkak të moskoordinimit ndërmjet institucioneve dhe mungesës së kriterëve të qarta për zbatim në praktikë. Gërxhaliu ka kritikuar afatin 60 ditore të përcaktuar me vendim administrativ nga ministri i Financave për kalimin në sistemin digjital, duke e quajtur të papërgatitur dhe të rrezikshëm për ambientin e të bërit biznes në Kosovë. “Derisa ministri me një vendim administrativ e përcakton një periudhë kohore 60-ditore që të kalohet në digjitalizim, në të



njëjtën kohë nuk përcakton kriterë të sakta. Administrata tatimore e sfidon sektorin privat duke i detyruar të kthehen dhe të blejnë edhe më tutje arka fiskale. Është një situatë e cila po e dëmton ambientin e të bërit biznes në Kosovë duke dëmtuar sektorin privat në masë të madhe. Proceset të tilla kërkojnë parapërgatitje, kërkojnë në rend të parë dialog, kërkojnë periudha pilotuese, të dhëna bazike ku ruhen të dhënat dhe kush i menaxhon dhe kush

është ai që shpik këtë softuer. Dhe mbi të gjitha, ka vende të cilat bëjnë subvencionimin e një tranzicioni të tillë”, ka thënë ai. Gërxhaliu ka theksuar se vendimet e tilla kërkojnë përgatitje të mirëfilltë, dialog paraprak, faza pilotuese, të dhëna të qarta mbi sigurinë dhe menaxhimin e sistemit, si dhe subvencionim të procesit, siç ndodh në vendet e tjera. “Në Kosovë kjo nuk është duke ndodhur, e tërë kjo mbetet barrë e sektorit privat edhe për

të blerë arkat fiskale, edhe për të kaluar në sistemin e digjitalizimit, por edhe për të paguar gjoba nga ATK-ja”, ka thënë ai. Gërxhaliu ka paralajmëruar se mungesa e përgatitjes dhe afati i shkurtër për implementimin e fiskalizimit digjital mund ta rrisë edhe evazionin fiskal. “Nuk mund të kalohet një proces i tillë në një periudhë kohore 60-ditore, kur në vendet e rajonit një proces i tillë ka zgjatur 2-3 apo 4 vjet dhe ende nuk është i finalizuar. Në aspektin ligjor ka qenë një vendim me ngut. Kjo në mënyrë indirekte e dëmton edhe buxhetin e shtetit, sepse e rrit informalitetin dhe në vend që të lëshohen kuponë fiskalë në mënyrë profesionale, tani e tutje lëshohen vetëm paragonë dhe e tëra kjo vetëm e rrit ekonominë informale në Kosovë, e cila pothuajse në mungesë të sundimit të rendit dhe ligjit, në mungesë të një dialogu të mirëfilltë, është shndërruar në një sëmundje kancerogjene të ekonomisë kosovare” ka thënë Gërxhaliu.

AKB-ja: PRODUKTET SERBE KANË PUSHTUAR TREGUN, QEVERIA PO RREZIKON PRODHIMIN VENDOR DHE VETËVENDOSJEN EKONOMIKE

PRISHTINË, 7 KORRIK - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka reaguar ashpër ndaj rritjes së madhe të importeve nga Serbia, duke e cilësuar këtë si një “pushtim të heshtur” dhe një kërcënim serioz për prodhimin vendor dhe pavarësinë ekonomike të vendit. Sipas të dhënave të publikuara nga AKB-ja, importet nga Serbia janë rritur mbi 118 për qind në krahasim me vitin e kaluar nga 50.64 milionë euro në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 në 110.53 milionë euro për të njëjtën periudhë të vitit 2025. “Kjo rritje nuk është thjesht një statistikë ekonomike, por një sinjal i qartë i rikthimit agresiv të produkteve serbe në tregun tonë dhe i rrënimit të prodhuesve vendorë”, është



thënë në reagimin e AKB-së. Më tutje, AKB-ja ka vlerësuar se kjo gjendje është pasojë e heqjes së masave kufizuese ndaj mallrave serbe nga ana e Qeverisë së Kosovës në tetor të

vitit të kaluar. “Produktet ‘Made in Kosovo’ po zëvendësohen nga ato serbe në rafte, në tregje e në tryezat tona”, është thënë në reagimin e AKB-së, duke shtuar se kjo nuk është vetëm

çështje ekonomike, por çështje dinjiteti dhe vetëvendosjeje. AKB-ja ka thënë se është e papranueshme që një shtet që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës ta dominojë ekonominë vendore, pa reciprocitet dhe pa kriterë mbrojtëse të përcaktuara qartë. “Ironikisht, ata që dikur protestonin kundër ‘maunave serbe’, sot heshtin, madje e lehtësojnë hyrjen masive të këtyre mallrave”, është thënë në reagim. AKB-ja ka bërë thirrje për ndërgjegjësim qytetar dhe institucional, duke ftuar konsumatorët t’i mbështesin prodhuesit vendorë dhe të tregojnë kujdes në zgjedhjet që bëjnë: “Konsumoni produkte vendore! Mbështesni ekonominë tonë, prodhuesin

tonë dhe pavarësinë tonë!”. Në përmbyllje të reagimit, AKB-ja ka ngritur alarmin se Kosova nuk mund të ndërtojë një të ardhme të qëndrueshme mbi importin e identitetit ekonomik të tjetrit, dhe se duhet të zgjedhë midis një “tregu të lirë dhe një shteti të lirë”. Lidhur me këtë çështje ka reaguar ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati. Ai ka thënë se këto raportime janë lajme të rreme, derisa ka publikuar një grafik të importit nga Serbia përgjatë viteve dhe muajve. “Çfarë thonë lajmet e rreme? – Importi nga Serbia rritet 100 për qind (pa treguar fare periudhën krahasuese, apo kontekstin kohor e rrethanor). Qysh në të vërtetë është importi nga Serbia”, ka theksuar Murati.

Ku e blen Kosova naftën dhe karburantet e tjera?

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kosova ka importuar gjithsej 338.5 milionë litra karburante gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025. Pjesa më e madhe, 130.6 milionë litra, që kapin vlerën e 84.7 milionë eurove, kanë ardhur nga Arabia Saudite, duke e renditur atë si furnizuesen kryesore të vendit.

Sipas të dhënave zyrtare që “Radio Evropa e Lirë” ka marrë nga Dogana e Kosovës, thuhet se në muajin janar çmimi mesatar për një litër karburant ishte 74.8 centë, ndërsa në muajin qershor është rritur në 80.8 centë, duke reflektuar luhatjet në tregun global të energjisë.

Pas Arabisë Saudite, ndër furnizuesit kryesorë renditen: Greqia me 61.5 milionë litra karburante (41.6 milionë euro), India me 52.7 milionë litra (35 milionë euro), Italia me 32.9 milionë litra (24.4 milionë euro) dhe Kuvajti me 18.9 milionë litra (11.9 milionë euro).



GJYQI QË KA TRONDITUR BOTËN

Për dy vite me radhë, misteri i asaj që ndodhi në tryezën e drekës së Erin Patterson ka ngërthyer vëmendjen e botës.

Pesë persona u ulën për të ngrënë drekë në shtëpinë e saj në një zonë rurale të Australisë më 29 korrik 2023. Brenda një jave, tre prej tyre do të ishin të vdekur, një i katërt do të luftonte për jetën, dhe e pesta – vetë Erin – do të ishte nën hetim për helmim të qëllimshëm të të ftuarve me kërpudha të egra.

Pas një gjyqi shumë të ndjekur në qytetin e vogël Morwell, Erin është shpallur fajtores për vrasjen e tre të afërmeve dhe përpjekjen për të vvarë një tjetër.

Me sytë nga juria gjatë gjithë kohës, ajo qëndroi e heshtur dhe e përmbajtur ndërsa u shpall verdicti që mund ta çojë në burgim të përjetshëm.

E vetëquajtura dashuruese e kërpudhave dhe kërkuese amatore kishte deklaruar në gjykatë se gjithçka ishte një aksident tragjik. Por gjatë nëntë javëve, juria dëgjoi prova që sugjerorin se ajo kishte kërkuar me qëllim kërpudhat vdekjeprurëse në qytetet përreth dhe kishte joshur viktimat drejt asaj dreke fatale nën pretekstin e rremë se kishte kancer – për të tentuar më pas të fshehë krimin duke gënjyer policinë dhe zhdukur provat.

Pjata portokalli

Prindërit e burrit të Erin-it, Gail dhe Don Patterson, kishin mbërritur në derën e saj pak pas mesditës atë të shtunë fatkeqe, me një tortë portokalli në dorë. Me ta ishin edhe familjarët Wilkinsons: Heather, motra e Gail-it, dhe bashkëshorti i saj Ian – i cili, disa javë pas asaj dreke, do të zgjohej nga koma për të zbuluar se ishte i vetmi i mbijetuar nga të ftuarit.

Ajo që binte në sy ishte mungesa e Simon Patterson, bashkëshortit të ndarë të Erin-it. Ai ishte tërhequr një ditë më parë, duke thënë se nuk ndjehej mirë që të merrte pjesë për shkak të tensioneve mes çiftit të ndarë.

Erin kishte kaluar mëngjesin duke punuar mbi një recetë nga një prej kuzhinierëve më të dashura të vendit, të cilën e kishte përshtatur për të përgatitur racione individuale të "bifteku Wellington" – copa të shtrenjta mishi të lyera me një pastë kërpudhash dhe të mbështjella me brumë.

Ian tregoi para jurisë se pa teksa këto racione vendoseshin në katër pjata gri – dhe një pjatë portokalli për Erin – të shoqëruara me puré patatesh, bishtaja jeshile dhe salcë mishi në anë.

Një racion i gjashtë, i përgatitur supozohet për Simon nëse ai ndryshonte mendje dhe vinte, u fut në frigorifer. Erin fillimisht ishte akuzuar edhe për përpjekje për ta vvarë atë – në disa raste – por ato akuza u hoqën një ditë para fillimit të gjyqit dhe nuk iu paraqitën jurisë.

Grupi tha lutjen para ngrënies dhe më pas nisën vaktin, duke shkëmbyer batuta për sasinë që po hanin.

"Flitej për burrat që ndihmonin gratë e tyre," tregoi Ian.



Të ngopur, ata hëngrën ëmbëlsirën, para se Erin t'i habiste me një deklaratë që kishte kancer, dëgjoi gjyqi.

Edhe mbrojtja pranon që kjo nuk ishte e vërtetë. Por atë ditë, çiftet e moshuar i dhanë Erin këshilla se si t'ua thoshte fëmijëve të saj, përpara se ta mbyllnin vaktin ashtu siç e nisën – me një lutje.

Ian i tha gjykatës se nuk e njihte mirë mikpritësen, por "gjërat ishin miqësore".

"Ajo më dukej thjesht një person normal," tha ai.

Brenda asaj nate, të gjithë mysafirët u sëmurën rëndë, dhe ditën pasuese katër prej tyre shkuan në spital me simptoma të rënda. Donald – i cili kishte ngrënë pjesën e tij të ushqimit dhe rreth gjysmën e asaj që hëngri gruaja e tij – i tha mjekut se kishte vjellë 30 herë brenda disa orësh.

Dyshimet filluan të lindin shpejt. Gjyqi dëgjoi se disa nga ata të ftuar në drekë ishin habitur nga ftesa. Simon tha se ishte e rrallë që ish-gruaja e tij të organizonte një gjë të tillë, ndërsa Ian tha se ai dhe bashkëshortja e tij e ndërë nuk kishin shkuar asnjëherë më parë në shtëpinë e Erin.

Në retrospektivë, një nga mysafirët kishte pyetur me zë të lartë pse Erin i kishte shërbyer vetes në një pjatë të ndryshme nga familja.

"Kam menduar për këtë që nga dreka," tha Heather, sipas një dëshmitari. "A i mungojnë Erin pjatat?"

Më vonë, në spitalin në Leongatha, mysafirët e sëmurë pyetën nëse edhe mikpritësjja ishte sëmurë. Të gjithë kishin ngrënë të njëjtën vakt, apo jo?

Detektivët do t'i bënë pyetje të ngjashme disa ditë më vonë, në dhomën e intervistës në polici me Erin.

"Po përpigemi të kuptojmë se çfarë i ka bërë ata kaq të sëmurë," dëgjoheshin të thoshin detektivët në një regjistrim që u luajt në gjyq. "Në anën tjetër, po përpigemi të kuptojmë pse ti nuk je aq e sëmurë."

Erin Patterson e përshkroi drekën për herë të parë publikisht në gjyq. Ajo i tha gjykatës se pasi të kishte përshëndetur të afërmit, kishte pastruar kuzhinën dhe më pas i kishte bërë vetes një shpërblim duke ngrënë një copë nga torta portokalli që kishte sjellë Gail.

"[Hodha] një copë tjetër torte, dhe pastaj edhe një copë tjetër," tha ajo. Para se ta kuptonte, torta ishte mbaruar dhe ajo ndihej shumë e ngopur.

"Prandaj shkova në tualet dhe e nxora përsëri," i tregoi Erin gjykatës.

"Pas kësaj ndihesha më mirë."

Ajo tregoi para jurisë për një luftë të fshehtë me buliminë, duke thënë se kishte pasur episode të rregullt të ngrënies së tepruar dhe pastaj pastrimit që nga adoleshenca – diçka që sipas avokatëve të saj shpjegonte mungesën e simptomave të helmimit.

Dy ditë pas drekës, Erin shkoi vetë në spital, duke raportuar se ndihej keq. Por fillimisht ajo refuzoi me këmbëngulje lutjet urgjente të stafit që ajo dhe fëmijët e saj – për të cilët pretendonte se kishin ngrënë mbetjet e ushqimit – të shtroheshin menjëherë për trajtim.

Një mjek i "habitur", i cili kishte parë gjendjen e rëndë të pjesëtarëve të tjerë të drekës, u shqetësua aq shumë për sigurinë e tyre sa që kontaktoi policinë për ndihmë.

Por kur mjekët më në fund e bindën Erin të bëhej kontrolli, as ajo dhe as fëmijët nuk shfaqën simptoma të ngjashme me të tjerët që kishin ngrënë në atë drekë. Testet nuk treguan asnjë gjurmë të helmimit të kërpudhave.

Pas një qëndrimi paraprak 24-orësh, Erin u largua nga spitali.

Flamuj të kuq

Ndërsa viktimat e saj vazhdonin të vuanin në spital – me të vjella dhe diarje të pakontrollueshme që përshkallëzoheshin në dështim organesh – prokurorët pretendojnë se Erin po përpiquej të mbulonte gjurmët.

Ditën pas daljes nga spitali, kamerat e sigurisë e kapën Erin duke shkuar në një pikë grumbullimi mbeturinash lokale dhe duke hedhur një dehidratues ushqimi, i cili më vonë rezultoi se kishte gjurmë të kërpudhave helmuese.

Gjithashtu, ajo po përdorte tre telefona rreth kohës së drekës, dy prej të cilëve u zhdukën menjëherë më pas. Telefoni i vetëm që ia dorëzoi policisë ishte fshirë vazhdimisht – përfshirë edhe gjatë kohës kur hetuesit po kontrollonin shtëpinë e saj.

Për hetuesit, sinjalet alarmante filluan të grumbulloheshin shpejt. Kur u pyet për burimin e kërpudhave, përgjigjet e Patterson ishin të çuditshme. Ajo pretendoi se disa prej tyre i kishte blerë të thata në një dyqan aziatik në Melburn, por nuk mbante mend në cilën lagje. Kur u pyet për markën apo ndonjë provë blerjeje, tha se ishin në ambalazh pa emër dhe se duhet të ketë paguar me para në dorë. Ndërkohë, hetuesit zbuluan se kërpudhat helmues 'death cap'

(kapelet e vdekjes) ishin parë në dy qytete pranë zonës ku banonte Erin, në javët para drekës fatale. Banorë të shqetësuar kishin postuar foto dhe vendndodhjet në bazën online të të dhënave për bimët, iNaturalist. Historia e kërkimeve në internet e Erin tregonte se ajo e kishte përdorur këtë faqe për të parë vendndodhjet e kërpudhave helmuese, të paktën një herë më parë.

Të dhënat e vendndodhjes nga telefoni i saj mobil duket se e tregonin atë duke udhëtuar drejt të dy qyteteve – dhe duke blerë dehidratuesin e ushqimit famëkeq gjatë kthimit nga një prej atyre udhëtimeve.

Por përpara policisë, Erin mohoi se kishte ndonjëherë një pajisje të tillë, pavarësisht faktit që një manual përdorimi për dehidratues u gjet në sirtarin e kuzhinës së saj, dhe pavarësisht postimeve në një grup në Facebook për krime të vërteta, ku ajo mburrej se po e përdorte.

Në njërin prej tyre, ajo shkruante: "Kam fshehur kërpudha pluhur në gjithçka. I përজেja në çokollatë 'brownies' dhe fëmijët nuk e kishin fare idenë".

Kur ekspertët e forensikës digjitale arritën të rikuperonin disa nga materialet në pajisjet e saj, ata gjetën fotografi që tregonin diçka që ngjante me kërpudhat helmues, të vendosura mbi një peshore kuzhine.

Gjatë gjyqit, Erin dëshmoi se vetëm disa ditë pas drekës i kishte shkuar në mendje që ndoshta bifteku Wellington-i mund të kishte përfshirë gabimisht kërpudha të thata që ajo i kishte mbledhur vetë dhe i kishte përzier pa dashje me ato të blera në dyqan. Por kishte qenë shumë e "frikësuar" për ta treguar këtë.

"Ishte një reagim idiot, instiktiv... për të gërmuar më thellë e për të vazhduar me gënjeshtren," tha ajo në gjykatë.

Pa motiv të qartë

Asgjë nuk ishte e qartë për policinë kur vinte puna te motivi.

Simon dëshmoi në gjyq se ai dhe Erin kishin mbetur miq dhe flisnin lirshëm pas ndarjes së tyre në vitin 2015. Por sipas tij, gjithçka ndryshoi në vitin 2022, kur mes çiftit nisën mosmarrëveshjet për financat, pagesat për fëmijët, shkollat dhe pronat.

Megjithatë, ai tha se nuk kishte pasur asnjë shenjë që Erin të kishte ndonjë armiqësi ndaj familjes së tij. "Sidomos me babain e kishte shumë mirë. Ndante me të dashurin për dijen dhe mësimin." Me zërin që i dridhej, Simon shtoi: "Mendoj se ajo e donte natyrën e tij të butë."

Por vetë Erin i tha gjykatës se po ndjehej gjithnjë e më e izoluar nga familja Patterson – dhe u paraqitën prova që tregonin se ajo ishte bërë e frustrar ndaj tyre.

"Ke pasur dy fytyra," i tha prokurorja Nanette Rogers, pasi e detyroi Erin të lexonte me zë mesazhe në Facebook plot fyerje, ku ajo e quante Simon-in "një dështak" dhe prindërit e tij "një kauzë e humbur".

Megjithatë, prokuroria zgjodhi të mos paraqiste një motiv specifik,

duke thënë se juria mund të mbetet ende me pyetjen se çfarë e shtyu Erin të vriste, edhe pasi gjyqi të kishte përfunduar.

Mungesa e një motivi të qartë ishte thelbësore për mbrojtjen e Erin: pse do të donte ajo të vriste familjen e saj, njerëz që – sipas saj – i donte si prindërit e vet?

"Prindërit e mi nuk janë më. Gjyshërit e mi nuk janë më. Ata janë e vetmja familje që kam... I dua shumë," u tha ajo policëve gjatë marrjes në pyetje.

Avokati i saj mbrojtës argumentoi se gjithçka tjetër mund të shpjegohej.

Mesazhet ku ajo kritikonte të afërmit e burrit ishin thjesht shkarkim emocionesh të padëmshme; gënjeshtra për kancerin ishte një justifikim për operacionin e humbjes së peshës që po planifikonte, por për të cilin ndjehej shumë në siklet për ta pranuar.

Të dhënat e vendndodhjes nga celulari nuk ishin aq precize, kështu që nuk kishte prova të qarta se ajo kishte vizituar realisht qytetet ku ishin parë kërpudhat helmuese.

Gjithashtu, ata sugjeruan se Erin ishte sëmurë pas vaktit, thjesht jo aq rëndë sa të tjerët sepse ajo e kishte vjellë ushqimin. Ajo e urrente të shkonte në spital – prandaj ishte larguar prej andej kundër këshillës mjekësore.

Ndërsa gënjeshttrat dhe përpjekjet për të zhdukur provat ishin sjellje e një gruaje që kishte frikë se mos fajësohej për vdekjet aksidentale të të ftuarve të saj.

"Erin nuk po gjykohet për gënjeshtra," tha avokati mbrojtës Colin Mandy. "Ky nuk është një gjykim moral."

Ai akuzoi prokurorinë se po përpiquej të detyronte një "puzzle" provash të përshtatej, duke "shtrembëruar interpretimet dhe injoruar shpjegime alternative vetëm sepse nuk përputhen saktësisht me narrativën e tyre".

Por prokuroria argumentoi se Erin kishte thënë aq shumë gënjeshtra, sa ishte e vështirë të mbareshin mend të gjitha.

"Ndoshta më e pabesueshmja," tha prokurorja Dr. Rogers, ishin përpjekjet e saj për të shpjeguar gënjeshtren për kancerin. Për të provuar se kishte planifikuar të bënte operacion për vendosjen e një rripi gastrik, Erin pretendoi se kishte caktuar një takim në një klinikë në Melburn – e cila nuk ofronte fare një trajtim të tillë.

"Ajo ka thënë gënjeshtër pas gënjeshtre sepse e dinte që e vërteta do ta implikonte," tha Dr. Rogers. "Kur e kuptoi që gënjeshttrat e saj ishin zbuluar, shpiku një rrëfim të kujdesshëm për të përputhur me provat – por jo plotësisht."

Dr. Rogers tha se juria nuk duhet të kishte asnjë vështirësi për të refuzuar argumentin se "kjo ishte thjesht një aksident i tmerrshëm gjatë mbledhjes së kërpudhave". Në fund, pas një jave diskutimesh, juria bëri pikërisht këtë.

Erin do të kthehet në gjykatë për një seancë dënimi në një datë të mëvonshme.



EuroBasketi në Pejë

PEJË, 7 KORRIK - Qyteti i bukur i Pejës do të jetë mikpritës i FIBA U16 Women's, EuroBasket Divizioni C. Kjo është hera e parë që një evropian zhvillohet në Pejë. Në këtë garë shumë të

rëndësishme do të marrin pjesë tetë kombëtare, që janë të ndara në dy grupe. Eventi do të organizohet nga 8 deri më 13 korrik. Vashat e Kosovës U16 janë në Grupin B, ku do të përballen

me Maltën, Shqipërinë dhe Moldavinë. Dardanet e reja kanë nevojë për përkrahjen nga publiku në Pejë në mënyrë që të kenë paraqitje sa më dinjitoze për këtë evropian.

Basketbollistet e reja të Kosovës janë stërvitur intensivisht për paraqitje sa më të mira. Edicionin e fundit e kishte fituar Azerbajxhani me një fitore në finale ndaj Qipros.



DRITA PËRBALLET SONTË ME DEIIFERDANGËN



“Epoka e re”

PRISHTINË, 7 KORRIK - Disa nga klubet elitare të futbollit në Kosovës rikthehen në aksion gjatë mesjavës pasi do t'i kenë sfidat në garat evropiane. Siç dihet, Kosovën e përfaqësojnë katër skuadra në tri garat evropiane, Liga e Kampionëve, Liga e Evropës dhe Liga e Konferencës. Skuadra më e mirë e vitit 2024/2025, Drita nga Gjilani, sot (e martë) e zhvillon

ndeshjen e parë në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, në kuadër të rrethit të parë në Ligën e Kampionëve, derisa përballë do ta ketë skuadrën nga Luksemburgu, Deiiferdange. Ndaj kësaj të fundit Drita llogaritet si favorite për të kaluar tutje dhe në rast të kalimit në rrethin e dytë përballë do ta ketë skuadrën e Kopenhagënit. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 20:00. Ndërkohë, fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina

më 10 korrik në orën 19:00 në kuadër të rrethit të parë në Ligën e Evropës përballët me Sheriff Tiraspolin. Ndërkaq, Malisheva, si e treta e renditur në Superligë në edicionin e fundit, do të luajë në rrethin e parë kualifikues të Ligës së Konferencës, ndërsa do të ketë punë me ekipin islandez, Vikingur. Kurse Ballkani do të luajë në rrethin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës dhe, rrjedhimisht, në xhiron e parë do të pushojë.

TREPÇA ‘BLINDON’ HAJRIZIN, RIKTHEN ZEKIQIN DHE TRANSFERON PAYNEN

“Epoka e re”

MITROVICË, 7 KORRIK - Basketbollisti Drilon Hajrizi do të jetë pjesë e KB Trepçës edhe për sezonin e ri. Lajmi është konfirmuar nga kampionia e Kosovës. Në njoftim thuhet se Hajrizi ka vazhduar kontratën edhe për një vit dhe pritet të jetë lojtar i rëndësishëm për sezonin 2025/26. “Drilon

Hajrizi zyrtarisht vazhdon me ne edhe për këtë vit. Ai është shtylla e ekipit dhe figurë udhëheqëse brenda dhe jashtë parketit. Vazhdojmë bashkë drejt synimeve të mëdha”, thuhet në njoftimin e Trepçës. Ndërsa fundori amerikan, Jacori Payne është përf forcimi i parë i huaj te KB Trepça për sezonin 2025/26. Ekipi nga Mitrovica, e ka prezantuar 29-vjeçarën që është i

gjatë 180 centimetra dhe së fundmi ishte në kategorinë e dytë të Francës. Payne, në Francë ka luajtur me një mesatare prej 13 pikëve e 5 asistimeve kurse karrierë në Evropë ka bërë edhe në Turqi, Zvicër, Holandë e Armeni. Para fundorit Payne, Trepça ka transferuar edhe qendrën Shawn Jones, i cili llogaritet vendor për shkak se është i pajisur me pasaportë të

Kosovës. KB Trepça u tregua shumë aktive në orët e fundit, pasi e ka rikthyer në radhët e saj basketbollistin Burim Zekiqi. “Burim Zekiqi është kthyer aty ku e ka zemrën. Fanellën dhe ngjyrat që s'i harroi kurrë, tani i mban përsëri me krenari. Burimi është gati të luftojë për to, si gjithmonë. Mirë se u ktheve, Buja”, thuhet në njoftimin e mitrovicasve.



BURIM ZYMERI PO E NDAN DREJTËSINË NË EVROPIANIN U16



PRISHTINË, 7 KORRIK - Kampionati Evropian për vajza U16, që po zhvillohet për herë të parë në histori në Prishtinë dhe Tiranë, po shënon një sukses të jashtëzakonshëm në organizim, mikpritje dhe përfaqësim. Një nga figurat kyçe të këtij suksesi në aspektin teknik është gjyqtari me thirrje ndërkombëtare, Burim

Zymeri, i cili po ndan drejtësinë në Grupin II që po luan ndeshjet në kryeqytetin tonë. Zymeri, pas një përvoje të pasur në shumë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, ka ndarë drejtësinë në katër ndeshje brenda katër ditëve, nga gjithsej shtatë që do të luhen në këtë grup, dhe do të jetë në aksion edhe në tri

ditët e mbetura të garës. Angazhimi i tij i pandërprerë tregon nivelin e lartë profesional dhe respektin që gëzon në strukturat e volejbollit evropian. Përveç prezantimit të shkëlqyer organizativ dhe mundësisë historike për përfaqësimin e Kombëtares sonë U16, prania e një gjyqtari të Kosovës në këtë

nivel është një vlerë e shtuar për Federatën e Volejbollit të Kosovës. Ajo dëshmon zhvillimin e vazhdueshëm të volejbollit në vendin tonë në të gjitha segmentet. FVK-ja i uron Burim Zymerit shumë suksese në detyrat e radhës dhe e falënderon për përfaqësimin dinjitoz në arenën ndërkombëtare.

Edhe Evertoni në garë për Zhegrovën

LIVERPOOL, 7 KORRIK - Ylli i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, pritet të largohet nga Lille gjatë verës. Interesim për të kanë shfaqur skuadrat si Napoli, Atalanta dhe Fenerbahçe, derisa tash kësaj liste i është shtuar edhe klubi i njohur nga Premierë Liga,

Evertoni. Tek Evertoni po e pëlqejnë Zhegrovën, duke pasur parasysh stilin e lojës së tij dhe depërtimet nga krahu. Ekipi anglez ende nuk ka bërë ndonjë ofertë zyrtare për Zhegrovën, i cili ka kontratë deri në vitin e ardhshëm me Lillen, që po kërkon 25 milionë

euro për kartonin e tij. 26-vjeçari i është bashkuar Lille në stërvitje, por do të largohet nga ekipi francez, për të cilin nuk ka luajtur për më shumë se gjashtë muaj shkaku i lëndimit. Në sezonin e fundit Zhegrova ka shënuar 8 gola dhe ka bërë 2 asistime në 21 paraqitje. Ditë

më parë largimin e Zhegrovës e ka bërë me dije edhe presidenti i ekipit francez, Olivier Letang. “Edoni ka shprehur dëshirën për t'u larguar. Nuk më duket e përshtatshme ta mbajmë me një vit të mbetur në kontratë. Presim largimin”, ka deklaruar Letang.



Hamiltoni sërish kundër Ferrari: Në Silverstone humbën 3-4 pozicione për shkak të strategjisë

NORTHAMPTON, 7 KORRIK - Gara e zhvilluar të dielën në pistën e Silverstones ishte një shans i mirë për Ferrarin për të fituar apo ngjitur në podium, por nuk ndodhi asnjë nga këto. Lewis Hamiltoni u rendit i katërti, ndërsa Charles Leclerc në vendin e 14-t. Në një fundjavë ku për

shkak të kushteve atmosferike situata ishte shpesh kaotike, “kokëkuqja” nuk arriti dot të përfitojë. Duke folur për garën e shtëpisë, Hamiltoni ka thënë: “Ishte një garë e vështirë që në fillimin e saj”. “Na mungon stabiliteti, veçanërisht në kthesat e

ngadalta. Makina rrëshqet, nuk kthehet. Mendohej të ndryshoj diçka me levat, por është shumë e komplikuar”, ka shtuar 7 herë kampioni i botës në Formula 1. “Gjithashtu humbëm tre ose katër pozicione vetëm në strategji, shpresojmë për një rezultat më të mirë në garën

tjetër”, ka deklaruar Hamiltoni. “Gjëja pozitive këtë fundjavë janë testet. Në sipërfaqe të thata ekuilibri është i mirë. Jemi shumë të fortë në kualifikime me drejtimin që kemi zgjedhur, madje edhe nga një garë si kjo mund të marrësh shumë tregues”, u shpreh britaniku.



Bayerni pas largimit të Mullerit: Thomasi është unik, ikonë dhe legjendë

MÜNCHEN, 7 KORRIK - Pas humbjes 2-0 ndaj PSG-së në çerekfinalet e Kupës së Botës për Klube, përfundon zyrtarisht një epokë e madhe në historinë e Bayern Munichut.

Thomas Mulleri, një nga figurat më emblematike të klubit bavarez, largohet pas 25 vitesh me fanellën gjermane. Një ditë pas ndeshjes, Bayerni publikoi në faqen zyrtare një letër emocionuese lamtumire kushtuar lojtarit të tij legjendar. “Nuk është e vështirë të gesh qindra Thomas Muller në vendet gjermanofolëse. Nga më shumë se 400 mijë anëtarë të klubit, 90 quhen Thomas Muller, por vetëm një prej tyre ka kënaqur tifozët në fushë për 25 vjet. Ai është në të njëjtin nivel me legjendat e mëdha të klubit si Beckenbauer, Gerd Muller, Maier, Hoeneß dhe Rummenigge. Thomas Muller është unik, ikonë, legjendë dhe gjithmonë një prej nesh”. Në letër theksohet se karriera e Mullerit nuk ndiqte shabllonet klasike. Nuk ishte as teknik si Messi



dhe as fizik si Ronaldo, por ishte mishërimi i efikasitetit në fushë. Ai shënonte gola të pamundshëm dhe bënte diferencën në mënyra të pazakonta, duke u shndërruar në motorin e skuadrës. Gjatë karrierës Mulleri fitoi gjithçka: dy herë tripletën, Kupën e Botës dhe 13 tituj të Bundesligës – një rekord

absolut. Legjenda e klubit Karl-Heinz Rummenigge ka thënë: “Thomasi i ka shfrytëzuar në maksimum të gjitha aftësitë e tij”. Ndërsa zbuluesi i tij, Hermann Gerland, ka shtuar: “Askush nuk e kishte parashikuar këtë karrierë. Kushdo që thotë se e kishte parë që në fillim, gënjen”.

Fury konfirmon datën dhe vendin e trilogjisë kundër Usykt

LONDËR, 7 KORRIK - Tyson Fury ka thënë se do të ndeshet me Oleksandr Usykun në një përballje trilogjike në stadiumin “Wembley” në prill. Në një postim në rrjetet sociale, 36-vjeçari tha se megandeshja e peshave të rënda do të zhvillohet në Londër, të shtunën, më 18 prill. Tyson Fury deklaroi se synon hakmarrjen kundër Usykut, ndërsa synonte një përballje tërësisht britanike me Anthony Joshuan. “Dua një shans të drejtë dhe nuk besoj se kam e pasur një të tillë dy herët e fundit. Nuk e di çfarë do të duhet të bëj, sepse nuk mund ta lë të shkojë në një vendim”, ka thënë Fury. Britaniku, ish-kampion bote në peshën e rëndë, u tërhoq nga boksi në janar të këtij viti, një muaj pas një humbjeje me vendim unanim ndaj Usykut në ndeshjen e dytë



midis tyre. Usyku fitoi edhe sfidën e parë në maj të vitit të kaluar me vendim shumice. Ndërkohë, Sergey Lapin, kreu i stafit të Usykut, nuk e minimizoi mundësinë e një takimi të tretë. Në një deklaratë për “Sky Sports”, Lapin shpjegoi se një

ndeshje e tretë ka qenë gjithnjë në tryezë. Gjithsesi, për momentin, fokusi i ukrainasit mbetet sfida e 19 korrikut kundër kampionit të botës në peshat e rënda të IBF, Daniel Dubois, po në stadiumin “Wembley”.

SHKURT

Asllani mund të transferohet në La Liga

Nuk dihet ende se ku do të luajë sezonin e ardhshëm Kristjan Asllani, teksa interesimi për mesfushorin shqiptar po rritet në prag të merkatos verore. Real Betisi ka shprehur interesim për lojtarin, duke e vëzhguar nga afër situatën e tij tek Interi, ku ai nuk ka arritur të bëhet titullar i rregullt. Sipas “Sky Sport”, Betisi mund të ndërmarrë hapa më të vendosur në javët në vijim, me qëllim që t’i sigurojë shërbimet e 22-vjeçarit. Asllani iu bashkua Interit me shumë pritshmëri, por deri tani ka pasur pak hapësira dhe e ardhmja e tij në Milano mbetet në dyshim. Interi nuk ka marrë ende një vendim përfundimtar, por një largim i mundshëm i Asllanit do të ndikonte drejtpërdrejt në balancat e mesfushës. Betisi ka bërë një hetim paraprak, ndërsa nuk përjashtohet mundësia që edhe klube të tjera t’i bashkohen garës për shërbimet e tij. Largimi i tij mund të hapë vend për përforcime të reja në mesfushën zikaltër, sidomos nëse ndodh edhe largimi i Hakan Calhanoglu, duke sinjalizuar një rishikim të mundshëm të strategjisë së Interit. Atalanta, gjithashtu, mbetet në garë për reprezentuesin shqiptar, megjithatë Interi gjatë javëve të ardhshme pritet ta marrë vendimin për të ardhmen e Asllanit.

Enrique, Realit: Ne jemi kampionët e Evropës

Pas triumfit në Ligën e Kampionëve një muaj më parë, skuadra e PSG-së vijon të shkëlqejë edhe në Botërorin për Klube. Kampionët francezë kanë shkuar në gjysmëfinale, ku do të përballen me Real Madridin. Trajneri i PSG-së, Luis Enrique, duke komentuar këtë rrugëtim, foli me superlativa për të tijtë. Sidomos pas fitores ndaj Bayern Munichut, ku e mbylli ndeshjen me 9 lojtarë. “Është folur shumë për qëndrueshmërinë dhe sigurisht që PSG-ja tashmë e ka atë. Ne jemi gati të jemi konkurrues në çdo kohë dhe pavarësisht rezultatit”, ka thënë Enrique. “Kur përballesh me ekipe si Bayern është e komplikuar kur luan 11 ndaj 11. Me dy lojtarë të përjashtuar mund të shndërrohet në lotari, por ia dolëm mbanë”, ka shtuar ai. “Ndaj Realit do të jetë e vështirë por, siç thashë, po fitojmë qëndrueshmëri në lojën tonë. Kjo na ka dhënë trofe, përfshirë edhe Ligën e Kampionëve. Jemi ne kampionët e Evropës, por të shohim se si do të shkojnë gjërat”, ka deklaruar trajneri spanjoll.

Interi i ofron kontratë pesëvjeçare Donnarummës

Tani nuk është më sekret që Interi ndjek Gigi Donnarummën. Zikaltrit kërkojnë prej vitesh portierin e PSG-së, por asnjëherë nuk janë krijuar kushtet e duhura për transferimin e tij. Sipas asaj që shkruajnë mediet italiane, klubi nga Milano ka gati propozimin për “gardianin”. Kontratë pesëvjeçare dhe rrogë e lartë për Donnarummën, kjo është ideja e Interit, që do të provojë të “joshë” 26-vjeçarin. Në karrierën e tij, portieri krenohet me 251 paraqitje me Milanin, 159 me PSG-në dhe 74 paraqitje me Italinë. Ai ka fituar një Kampionat Evropian, një Ligë të Kampionëve, 4 liga 1, një superkupë italiane, 3 superkupa franceze dhe 2 kupa franceze.

Al-Hilali arrin marrëveshje me Theo Hernandezin

Theo Hernandez do të largohet përfundimisht nga Milani. Mbrotjesi i majtë francez do ta vazhdojë karrierën në Arabinë Saudite, përkatësisht tek Al-Hilali.

Në fakt, klubi nga Saudi Pro League ka arritur marrëveshje me “rossonerët” për transferimin e futbollistit, me të cilin e kishte gjetur gjuhën e përbashkët

paraprakisht. Nga shitja e futbollistit francez kuqezinjë do t’i fitojnë 25 milionë euro. Një mbrojtës kualitativ i krahut të majtë për trajnerin Simone

Inzaghi. 27-vjeçari ishte transferuar te Milani në vitin 2019, ndërsa para pak vitesh ishte një prej mbrojtësve të majtë më të mirë në botë. E së fundmi

kishte rënie të formës dhe probleme me trajnerët e me disiplinën. Tash Milani do të vihet në kërkim të një mbrojtësi të majtë kualitativ.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Helios Power SH.P.K (I autorizuar Shaban Cacaj) me nr. të protokolit 4173/25 të datës 26.05.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaike dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Junik, me numër të parcelave:

Junik P-73105038-05052-0, P-73105038-05053-3, P-73105038-05036-0, P-73105038-04169-10, P-73105038-04169-11, P-73105038-05173-6, P-73105038-05173-1 dhe P-73105038-0553-4 me sipërfaqe totale prej 852,850 m² që ndodhen në Komunën e Junikut.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaike “Parku Solar Juniku A dhe B” për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.21.07.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:	
Kushtet Ndërtimore të propozuara: Helios Power SH.P.K. Deçan / Junik	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Mal i klasës 4,5 dhe 6 Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	5.5 - m’
c. Vija e ndërtimit.	7 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5-3.5 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	2.5 m 3.5 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	6 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	94 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	20
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Françesk Zefaj nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të lëshuar nga Sh.M. Mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Avdurrahim Fifaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Besnik Çarri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 13 dhe diplomën e SH.M Mjekësisë, “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Ani Kazazi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Mihill Tuqi nga Ujzi i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “At Gjergj Fishta”, Bishtazhin, Gjakovë.

- Erika Maksuti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Muzikës “Prenk Jakova”, Gjakovë.

- Butrinit Sharani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjobiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor

1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master

1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

